



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ 2019

Lënda: Nismë për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar”

Drejtuar: Z.Gramoz RUÇI

**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

**Tiranë**

I nderuar Z. Kryetar,

Mbështetur në nenin 81 pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006. “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar””.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Deputeti propozues

*Ilir Beqaj*  
*Ilir Beqaj*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. \_\_\_\_\_/2019

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9636, DATË 6.11.2006,  
“PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Neni 4 të riformulohet si vijon:

**“Neni 4**

1. Në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit duhet të shfaqen paralajmërime shëndetësore të kombinuara në tekst dhe në figurë për dëmet që shkakton në shëndet përdorimi i duhanit. Ato duhet të zënë 50 për qind ose më shumë të sipërfaqes së shfaqur, por jo më pak se 30 për qind të faqes kryesore. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë harton paralajmërimet shëndetësore të kombinuara dhe specifikimet teknike të vendosjes së tyre në paketë dhe i dërgon për miratim KNMSHPD. Fotografitë e figurave të paralajmërimeve të kombinuara duhet të kryhen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë me individë dhe/ose objekte brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të përditësohen herë pas here.
2. Paketat e duhanit duhet të plotësojnë standartet e paketimit të thjeshtë. Paketimi i thjeshtë bëhet në ngjyrat bardhe e zi ose dy ngjyra te tjera në kontrast sipas percaktimeve të KNMSHPD. Në paketim nuk vendoset asgjë tjetër përveç emrit të markës, emrit të produktit dhe/ose emrit të prodhuesit, detajet e kontaktit dhe sasia e produktit në paketim, pa logot apo veçori te tjera, me përjashtim të paralajmërimeve shëndetësore të

kombinuara, pulla tatimore dhe informacione ose shënime të tjera të miraturara nga KNMSHPD.

3. Ndalohet çdo lloj reklame apo promovim brenda paketës, ose e bashkangjitur në paketim, apo në cigare individuale ose produkte të tjera të duhanit".

## Neni 2

Në nenin 22, të shtohen dy paragrafë si vijon:

"Ngarkohet Ministria përgjegjëse për shëndetësinë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të hartojë formatin e paketimit të thjeshtë dhe paralajmërimet shëndetësore të kombinuara, tekst dhe figurë, që do të vendosen në produktet e duhanit.

Ngarkohet KNMSHPD-ja, që brenda 4 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë formatin e paketimit të thjeshtë dhe paralajmërimet shëndetësore të kombinuara, tekst dhe figurë, që do të vendosen në produktet e duhanit".

## Neni 3

### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet në 1 janar 2022.

**KRYETARI**

**GRAMOZ RUÇI**